



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në
“Bashkinë Konispol”

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR **AUDITIMIN TEMATIK**

“BASHKIA KONISPOL”

Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 – 7
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditmit	7 – 8
II	HYRJA	8 – 13
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodatat e auditimi. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13 - 32
III.1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13 - 14
III.2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	14 – 32
	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	32 – 34

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Sarandë.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj.

600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“Opinion i kualifikuar”**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1.	Nga testimi i llogarisë 32 “ <i>Inventari i imët</i> ” e cila paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020, aktive për të cilat është kryer inventar fizik dhe është krahasuar me Inventarin kontabël vetëm për vlerën 1,598,199 lekë	E lartë	14 - 32	Bashkia Konispol nëpërmjet një komisioni të ngritur me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin llog 32 “ <i>Inventari i imët</i> ”, për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogaritje në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Ndërsa për vlerën 2,822,680 lekë që i përket NJA Markat, e cila është e pa analizuar në kontabilitet nuk është kryer inventar fizik. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Markat i paraqitur pa analizuar këtë llogari, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. pika 30.			zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik. Të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” IV. “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”.
2.	Në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se, llog. 210 “ <i>Toka, Troje, Terrene</i> ” në bilanc paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 24,011,454 lekë. Edhe sipas Formatit 7/b “ <i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)</i> ” si mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2019 paraqitet në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, kjo është e pa analizuar, nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes,	E lartë	14 - 32	Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “ <i>Toka, Troje, Terrene</i> ” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 .			
3.	Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, <i>llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione”</i> paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 401,226,286 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 420,238,196 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata kosto historike)” në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 488,999,200 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 490,999,200 lekë me rritje prej 2,000,000 lekë si rezultat i investimit të kryer për rritjen e AQT “Rikonstruksion i Shkollës së Shalës” në vlerën 2,000,000 lekë. Referuar inventarit kontabël të gjendjes së kësaj llogaritje rezultojnë se: Bashkia Konispol ka 13 objekte në vlerën 300,235,141 lekë, analiza e së cilës sipas inventarit kontabël, Njesisë Administrative Xarrë ka 18 objekte me vlerë prej 31,586,314 lekë dhe vlera prej 159,177,745 lekë e Njesisë Administrative Markat. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është përfshirë vlera prej 159,177,745 lekë që i përket NJA Markat është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes	E lartë	14 - 32	Kryetari i Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 .			
4.	Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, llogaria 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,207,212,103 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,192,489,363 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,245,224,936 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,271,872,569 lekë me një rritje prej 26,647,633 leke, e cila ka ardhur si rezultat e rikonstrukcioneve të kryera në 5 aktive gjatë vitit 2020 si: “Rikons. Rrugë Shkallë – Çiflik” në vlerën 4,688,640 lekë, “Rik. Ujësjellës Konispol St.Pompa” në vlerën 963,000 lekë, Ndërtim Gropë septike dhe KUZ shkolla “Xarrë” në vlerën 956,160 lekë, Rikonstrukcion i rrjetit te ndriçimit rrugor ne fshatrat e Bashkisë Konispol faza II në vlerën 8,057,313 lekë dhe Rikonstrukcion i Ujësjellësit fshati Xarrë në vlerën 11,982,520 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 37 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 891,061,081 lekë sipas inventarit kontabël. Për AAGJM e llogarisë 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen e llogarisë 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” përfshihet edhe vlera prej 271,359,836 lekë që përfaqëson vlerën kontabël të trashëguar nga bilanci i ish Komunës Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në mungesë të inventarit fizik, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe	E lartë	14 - 32	Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 213 “ <i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i> ” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30.			
5	Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, gjendja e llog.218 “ <i>Inventar Ekonomik</i> ”, në mbyllje të pasqyrave financiare të viteve 2019 dhe 2020, paraqitet me kosto historike në të njëjtën në vlerën prej 19,568,174 lekë. Nga testimi i inventarit kontabël të aktiveve të kësaj llogarie, rezultoi se vlera prej 568,572 lekë i përket NjA Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të aktiveve dhe as kartela inventariale. Në vitin 2016 është bërë inventari fizik vetëm për gjendjen fizike në sasi, por pa çmim, pra mungon inventarizimi kontabël, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30.	E lartë	14 - 32	Spektori i Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Konispol, të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël prej 568,572 lekë të aktiveve të pasqyruara në llog. 218 “ <i>Inventar Ekonomik</i> ”, të bëhet inventarizimi nga komisioni i inventarizimit, të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, duke përcaktuar dhe personat përgjegjës material, si dhe të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore.

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinioni i pasqyrave financiare viti 2020:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol të periudhës ushtrimore 01.01.2020–31.12.2020, paraqitur dhe vitin paraardhës në çelje, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **kualifikuar**² për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Konispol

² Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020”.

Baza për opinionin:

Nga testimi i llogarive, konstatohet se sipas inventarit kontabël përfshihen vlera të paanalizuara për të cilat mungon inventari fizik e regjistri i aktiveve, si: llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” për vlerën 24,011,454 lekë, llog. 32 “*Inventari i imët*” për vlerën 2,822,680 lekë, llog 212 “*Ndërtesa Konstruksiione*” për vlerën 159,177,745 lekë, llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” për vlerën 271,359,836 lekë dhe llog. 218 “*Inventar Ekonomik*” për vlerën 568,572 lekë, aktiveve që i përkasin ish-Komunës Markat, të pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Stafi drejtues Bashkia Konispol, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin e brendshëm që nuk ka rezultuar efektiv për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe përdorimin e burimeve financiare të fondeve të prokuruar në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit).

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e siguri të arsyeshme. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Në komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin të cilat i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.06.2021 dhe autorizimit nr. 678/8, datë 14.06.2020 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.06.2021 – 02.07.2021, në Subjektin Bashkia Konispol për periudhën e

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

veprimtarisë nga 01.07.2019 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ**, Përgjegjës Grupi
2. **V. R**, anëtarë
3. **P. GJ**, anëtarë

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Konispol.

b- Marrësi: Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Konispol.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Konispol, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Konispol.

e-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) **SH. B** Kryetar i Bashkisë Konispol dhe Drejtori Financës në cilësinë e Nëpunësit zbatues (NZ) **E. D**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për

mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Konispol, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6³, neni 65, pika 1⁴ dhe neni 91, pika 1.3⁵.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Konispol dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatesia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

³ “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”

⁴ “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

⁵ “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

d) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”.

- *Vlerësimi dhe alokimi*: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

- *Transaksionet*, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

- *Plotësia*: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria*: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

- *Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njëjësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodatat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u

fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit⁶.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepëricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e

⁶ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁷.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Profili i bashkisë Konispol

Bashkia Konispol kufizohet në veri me Bashkinë Konispol, në perëndim me Bashkinë Konispol dhe në jug me Greqinë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti Konispol.

Kjo bashkia kë 3 njësi administrative si: NJA Xarrë, NJA Markat dhe NJA Konispol



- Të dhëna të përgjithshme

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Konispol ka një popullsi prej 8 245 banorësh ndërsa sipas regjistrimit civil ka 13 737 banorë. Sipërfaqja e bashkisë së re është 221.88 km². Sipas të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 37.1 banorë për kilometër katror ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 61.91 banorë/km².

⁷ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Profili i Bashkisë:

Bashkia Konispolit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Konispol ose për transportin ndërkufitar, ndërsa një pjesë e popullsisë kalon kufirin rregullisht për të punuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi.

Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat, ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Në fshatin Xarrë një përpjekje e përbashkët e komunitetit ka krijuar një kooperativë shumë të suksesshme të përqendruar te prodhimi i agrumeve, por pavarësisht suksesit të bujqësisë në Xarrë, popullsia e të gjithë zonës ka qenë në rënie të shpejtë gjatë dekadës së fundit.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse me Bashkinë Konispol dhe Bashkinë Konispol, si dhe me rrugën drejt pikës kufitare të Qafë-Botit.

Bashkia ka në territorin e saj një vijë bregdetare prej rreth 10 kilometra të gjatë e cila aktualisht është e pazhvilluar përreth Kepit të Stillos. Në këtë pjesë të bregdetit gjenden mes të tjerash Ishulli i Tongos, një shkëmb me sipërfaqe prej rreth 5 mijë metrash katrore pranë gjirit të Fteliat, në kufi me Greqinë, si dhe ishulli i Stilit, për të cilën bashkia nuk ka mundur të krijojë guida turistike për promovimin e zonës dhe sigurimin e të ardhurave në favor të buxhetit të Bashkisë Konispol.

-Ndikimi i pandemisë COVID-19 në jetën ekonomike

Mbi administrimin e ndihmave ushqimore në Bashkinë Konispol, të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DRRMSH).

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Konispol ka përfituar ndihma ushqimore, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Konispol, rezulton se Fletëdalja nr. 238, datë 03.06.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.9, datë 05.06.2020 për ushqimet në vlerën 64,922 lekë. Sipas listës së Zyrës së Ndihmës Ekonomike për 17 familje ushqimet janë bërë dalje nga magazina me Fletëdalje nr. 07, datë 06.06.2020.

Drejtoria Ekonomike në bashki ka kontabilizuar të gjitha veprimet në ditarin e magazinës, duke e debituar llogarinë përkatëse materiale.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

- Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr.2018, datë 10.08.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi i MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2020 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Konispol” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Sarandë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar.***

Bashkia Konispol për 2020 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduar, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese.

A.1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në procesin e auditimit tematik mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore (01.01.2020 deri 31.12.2020) në Bashkinë Konispol u konstatua se: Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Konispol periudha 2020 (Formati nr.1) është depozituar në Degën e Thesarit Sarandë me shkresë nr. 400 prot, datë 31.03.2021, duke respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pikat 118⁸.

Është plotësuar bilanci për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 me pasqyrat financiare dhe anekse të tyre e konkretisht me përbërjen si vijon:

- *Formati 1-* Pasqyra e pozicionit financiar (*bilanci*);
- *Formati 2-* Pasqyra e performancës financiare (*klasifikimi sipas natyrës ekonomike*), pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- *Formati 3-* Pasqyra e flukseve monetare (*Cash Flow*), sipas metodës direkte;
- *Formati 4-* Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- *Formati 5-* Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- *Formati 6-* Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- *Formati 7-* Pasqyrat anekse statistikore, Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, nga të cilat:
 - *formati 7/a-* Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me kosto historike.
 - *formati 7/b-* Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlera neto.
- *Formati 8-* Pasqyra anekse statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, të pozicionit financiar për Njësia Publike Bashkia Konispol; Formatin nr.1, paraqitet në pasqyrën ***Aneks nr. 1 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.***

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2020, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

A.AKTIVET

I. Rubrika, aktivet afat shkurtra.

1.Nën/rubrika, “*mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*”, gjendja Llog.(520) “***Disponibilitete në thesar***” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 18,976,581 lekë dhe më 31.12.2020 në vlerën 14,779,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm për:

-Gjendjen e mjeteve në ruajtje në vlerën 11,524,209 lekë,

⁸ Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit

-Grande dhe të ardhura të papërdorura 3,255,024 lekë.

Kjo llogari rakordon me Aktrakordimin i mbajtur me Degën e Thesarit Sarandë për gjendjen e fondeve në fund të periudhës ushtrimore më hollësisht sipas, pasqyrës **Aneks nr. 2 bashkëlidhur Raportit të Auditimit**.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese për vitin 2019 paraqiten në vlerën 5,110,042 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2020 paraqitet në vlerën 4,828,836 lekë, më pak për vlerën 281,206 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 407,957 lekë dhe në vitin 2019 në vlerën 689,163 lekë, vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020, aktive për të cilat është kryer inventar ekonomik, Inventari kontabël e fizik për gjendjen e kësaj llogaritje në 31.12.2020. Të dhënat e kësaj llogarie sipas pasqyrës **Aneks nr. 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit**.

Konkluzion: Sipas pasqyrës aneks nr. 3, vlera prej 2,822,680 lekë pjesë e gjendjes së llogarisë 32 “inventar i imët” që i përket ish-Komunës Markat është e pa analizuar dhe për të nuk ka inventar fizik.

1. Titulli i Gjetjes: *KLSH konstaton se në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imët ”, e cila paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020, është përfshirë dhe shuma prej 2,822,680 lekë që i përket inventarit të imët të ish-Komunës Markat, e cila është e pa analizuar dhe për të mungon inventari fizik.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020. Rezulton se aktive për të cilat është kryer inventar fizik dhe është krahasuar me Inventarin kontabël janë vetëm për vlerën 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së kësaj llogaritje në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Gjendja e llogarisë 32 “**Inventari i imët ”** sipas inventarit kontabël të NJA Markat, paraqitet në vlerën 2,822,680 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol të vitit 2015, pas mbylljes së ish-komunave Markat dhe Xarrë, sot Njësitë Administrative të bashkisë Konispol për të cilat këto aktive janë paraqitur me probleme dhe pa analizuar.

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti:

Paraqitje jo reale e këtyre aktiveve në këtë gjendje llogaritje të bilancit, përse i përket aktiveve afatshkurtra të ish-Komunës Markat. Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e besueshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari

Shkaku:

Mos inventarizimi kontabël e fizik i këtyre aktiveve dhe mos analizimi i këtyre vlerave në bazë të dokumentacionit bazë financiar nga të cilat kanë dalë këto shifra, e në mungesë të tyre mos kryerja e procedurave të vlerësimit të tyre

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “*Inventari i imët*” për shumën 2,822,680 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” IV. “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 33,655,360 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2019 në vlerën 24,953,147 lekë, ku kemi rritje duke e krahasuar me vitin paraardhës si rezultat i rritjes së llogarisë 468 dhe llogarisë 4342.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 27,335,804 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 19,076,093 lekë, me rritje për vlerën 8,259,711 lekë. Vlera prej 27,335,804 lekë janë debitorë për taksa e tarifa vendore për 54 biznese në vlerën 3,796,110 lekë dhe taksa e tarifa vendore familjarët në vlerën 23,539,694 lekë, sipas Aktrakordimin midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike.

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”** për vitin 2020 paraqitet në shumën 6,319,556 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 4,596,397 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 239,776 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 1,302,930 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 180,453 lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13,578,979 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 8,004,841 lekë. Për vitin 2020 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit për vlerën 13,578,979 lekë.

II. Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,678,109,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,686,742,262 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,877,702,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,848,063,198 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 489,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2019 me vlere 5,619,601 lekë

dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,108,601 lekë. Sipas Formatit 7/b të PF gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr. llog.	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesa gjatë vitit 2020		Gjendja ne fund viti 2019		
		kosto historike 31.12.2019	Amortizim I akumu luar	Teprica Neto 31.12. 2019	kosto historike	Amortizimi	Kosto historike 2020	Amortizim I akumuluar	Teprica Neto 2020
	I. TË PA TRUPËZUARA	6,108,601	5,619,601	489,000	0	489,000	6,108,601	6,108,601	0
201	Prime të emis. e rimbur. të huav								
202	Studime dhe kërkime	6,108,601	5,619,601	489,000	0	489,000	6,108,601	6,108,601	0

Referuar pasqyrës së mësipërme për vlerat e projekteve apo shpenzimeve për mbikëqyrje e studime të përfshira në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” që i përkasin investimeve të kryera në vite të mëparshme dhe që janë kapitalizuar si AQT, duheshin prerë artikuj kontabël për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivitetit. Ndërsa për vlerat e studimeve e mbetura, të cilat do të mbeteshin gjendje në këtë llogari, duhej përlllogaritur amortizimi për çdo vit në masën 15% në mënyrë lineare deri në amortizimin e plotë të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, **pika 36** në të cilin përcaktohet: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “*Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëposhtëm:*

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitet 2019-2020.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 1,678,109,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 1,686,253,262 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,871,594,257 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,841,954,597 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 24,011,454 lekë, pa diferencë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

historike)” në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2019 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar kësaj Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

2. Titulli i Gjetjes: KLSH konstatoi se, gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2019 (kosto historike) në vlerën 24,011,454 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Situata:

Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2019 dhe vitit 2018 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar kësaj Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”.

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti:

Paraqitje jo reale e këtyre aktiveve në këtë gjendje llogaritje të bilancit. Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e besueshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 401,226,286 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 420,238,196 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 488,999,200 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 490,999,200 lekë me rritje prej 2,000,000 lekë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT “Rikonstruksion i Shkollës së Shalës” në vlerën 2,000,000 lekë. Referuar inventarit kontabël të gjendjes së kësaj llogaritje rezulton se: Bashkia Konispol ka 13 objekte në vlerën 300,235,141 lekë, analiza e së cilës sipas inventarit kontabël paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 212 "Ndërtesa " me 31.12.2020 (Bashkia Konispol)

Nr. llog.	EMERTIMI	Gjendja në mbyllje të Ushtrimit 31,12,2019	Blerje e krijuar me pagesë	Gjendja në mbyllje të Ushtrimit 31,12,2020
212	Ndërtime e Konstruksione	488,999,200	2,000,000	490,999,200
	1-Godina e Zyrrave te Bashkisë	15,040,326		15,040,326
	2-Godina e Shkollës Konispol	111,814,974		111,814,974
	3-Godina Kopshtit Nr. 1 Konispol	18,779,799		18,779,799
	4-Godina e Shkollës Çiflik	8,000,000		8,000,000
	5-Godina e ujësjellësit	1,727,774		1,727,774
	6-Godina qendër shënd.Çiflik	2,811,259		2,811,259
	7-Fusha e sportit	2,486,385		2,486,385
	8-Vorrezat Klogjer	9,297,418		9,297,418
	9-Vorreza publike Markat	697,590		697,590
	10-Vorreza publike Shales	2,352,754		2,352,754
	11-Vorreza publike Janjar	659,760		659,760
	12-Godina e Shkolles Xarrë	69,335,626		69,335,626
	13 Godina e Shkolles Shales	55,231,476	2,000,000	57,231,476
	XARRA	31,586,314		31,586,314
	MARKATI	159,177,745		159,177,745

Njësia Administrative Xarrë ka 18 objekte në vlerën 31,586,314 lekë, analiza e së cilës sipas inventarit kontabël paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Inventari i llog. 212 "Ndërtesa " me 31.12.2020 (Njësia Administrative Xarrë)

Nr	Emërtimi	Vlefte	Viti i krijimit	Nr	Emërtimi	Vlefte	Viti i krijimit
1	Stacion pompimi	75,760	1988	10	Çerdhe Kopësht Xarrë	100,000	1976
2	Depo Uji Mursi V120 M3	36,638	1988	11	Çerdhe e vjetër	40,000	na
3	Depo Uji Xarrë	2,200,518	1996	12	Ambulanca Xarrë	60,000	1963
4	Linja e ujësjellësit Depo Mursi	2,277,653	1996	13	Shkolla 8-vjecare Vrine	200,000	na
5	Depo Uji V 100M3 Vjetra xarre	15,135	1974	14	Shkolla 8-vjecare Shkalle	130,000	na
6	Depo Uji V 100M3 Vjetra Vrine	15,130	1974	15	Zyrat e Komunës	5,288,140	na
7	Depo Uji V 50 M3 Vjetra Mursi	51,450	1972	16	Ambulanca Shëndelli	991,000	2005
8	Spital Mursi	86,679	1960	17	Çerdhe vj Mursi Qend Komun	1,520,000	na
9	Shkolla 8-vjecare Xarrë	5,628,906	1970	18	Shkolla e Bashkuar Mursi	12,869,305	na

Nr	Emërtimi	Vleftha	Viti I krijimit	Nr	Emërtimi	Vleftha	Viti I krijimit
10	Çerdhe Kopësht Xarrë	100,000	1976		Shuma	31,586,314	

Konkluzion: Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është përfshirë vlera prej 159,177,745 lekë që i përket NJA Markat është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

3. Titulli i Gjetjes: *KLSH konstatoi se, në gjendjen e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet “ndërtesa e konstrukione” të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 159,177,745 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Markat i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive.*

Situata:

Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 401,226,286 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 420,238,196 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 488,999,200 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 490,999,200 lekë me rritje prej 2,000,000 lekë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT “Rikonstrukion i Shkollës së Shalës” në vlerën 2,000,000 lekë. Referuar inventarit kontabël të gjendjes së kësaj llogaritje rezulton se: Bashkia Konispol ka 13 objekte në vlerën 300,235,141 lekë, analiza e së cilës sipas inventarit kontabël, Njesisë Administrative Xarrë ka 18 objekte me vlerë prej 31,586,314 lekë dhe vlera prej 159,177,745 lekë e Njesisë Administrative Markat. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është përfshirë vlera prej 159,177,745 lekë që i përket NJA Markat është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol.

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe mungesa e analizës për vlerën 159,177,745 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zberthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,207,212,103 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,192,489,363 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,245,224,936 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,271,872,569 lekë me një rritje prej 26,647,633 leke, e cila ka ardhur si rezultat e rikonstruksioneve të kryera në 5 aktive gjatë vitit 2020 si: “Rikons. Rrugë Shkallë – Çiflik” në vlerën 4,688,640 lekë, “Rik. Ujësjiellës Konispol St.Pompa” në vlerën 963,000 lekë, Ndërtim Grop septike dhe KUZ shkolla Xarrë në vlerën 956,160 lekë, Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor në fshatrat e Bashkisë Konispol faza II në vlerën 8,057,313 lekë dhe Rikonstruksion i Ujësjiellësit fshati Xarrë në vlerën 11,982,520 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 37 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 891,061,081 lekë sipas inventarit kontabël të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” me 31.12.2020

Nr.	EMERTIMI	Gjendje në çelje të ushtrimit	Blerje e krijuar me pagesë	Gjendje në fund të vitit ushtrimit	Nr.	EMERTIMI	Gjendje në çelje të ushtrimit	Blerje e krijuar me pagesë	Gjendje në fund të vitit ushtrimit
	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,245,224,936			20	Rik.ujesjellesi Markat	11,472,539		11,472,539
1	Rikons. Rrugë Çiflik (Fush -Rraha	3,447,576		3,447,576	21	Rik.rruge Mursi	2,760,900		2,760,900
2	Rikons. Rrugë brëndshme Çiflik	3,276,516		3,276,516	22	Rik.rruge Xarrë	7,340,976		7,340,976
3	Rikons. Rrugë Shkallë - Çiflik	11,000,000	4,688,640	15,688,640	23	Rik.rruge Udha Re Konisp	4,100,640		4,100,640
4	Rikons. Rrjetit ujr. zeza Konispol	4,300,000		4,300,000	24	Sist.ujra te zeza Xarrë	2,128,583		2,128,583
5	Rik. Ujësjiellës Konispol St.Pompa	269,886,049	963,000	270,849,049	25	Rik.rruge brendsh Ninat	1,651,175		1,651,175
6	Rikons.ndriçimi qëndr. Konispol	3,756,000		3,756,000	26	Rik.rrug brendsh Markat	356,184		356,184
7	Rikons.rrjetit brëndsh. Konispol	39,200,000		39,200,000	27	Rik.rruge brendsh Janjar	1,563,733		1,563,733
8	Rikons.Rrugë brënd Prroi thatë	11,730,000		11,730,000	28	Rik.Ujesjellesi Ninat	28,032,949		28,032,949
9	Rikons. Rrugë qëndër - shkollë	26,701,393		26,701,393	29	Rik.Ujesjellesi Mursi	10,155,319		10,155,319
10	Sist. asfal rrugë qëndër qytetit	185,952,078		185,952,078	30	Rik.Kanal vadit Konispol	31,897,725		31,897,725
11	Rikons. Rrugë qëndër - Postblllok	43,200,000		43,200,000	31	Rik.kanal vadites Shales	13,130,523		13,130,523
12	Rik.rrugë "Verrezi" Konispol	2,967,000		2,967,000	32	Rik.kanal vadites V-55	11,279,999		11,279,999
13	Rik.rrugë A.Cene - M.Mehmeti	5,355,761		5,355,761	33	Rik.unaza Shkalle - Mursi	60,262,008		60,262,008
14	Rik.Rrugë vorreza Çiflik	1,862,496		1,862,496	34	Rik.Udha e Re Konispol	9,642,020		9,642,020
15	Rik.rrug qënd-Breg Koçit zhade	19,350,030		19,350,030	35	Rikonstr.rrjeti elektrik	15,519,466		15,519,466
16	Rik.rrug qënd-Bregu Koçi këmb.	14,020,000		14,020,000	36	Nd. Grop sep.KUZ Sh.Xarrë		956,160	956,160

Nr.	EMERTIMI	Gjendje në çelje të ushtrimit	Blerje e krijuar me pagesë	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor	Nr.	EMERTIMI	Gjendje në çelje të ushtrimit	Blerje e krijuar me pagesë	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor
17	Rik.rrug bregu koçit (H.Papara	2,451,283		2,451,283	37	Rik ujesjelles fshati Xarrë		11,982,520	11,982,520
18	Rik.rrugë Unaza e vogël Shehat	2,442,108		2,442,108	38	Xarrë	109,451,649		109,451,649
19	Rik.rrug Argjinatu Rraha	2,220,420		2,220,420	39	Markati	271,359,836		271,359,836

Kjo llogari është e analizuar për 21 objekte dhe për **Njësinë Administrative Xarrë** për vlerën 109,451,649 lekë sipas inventarit kontabël të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Vlefte	Nr	Emërtimi	Vlefte
1	Ujësjiellësi shkalle	6,435,897	12	Muri fushës sportit xarre	1,171,640
2	Rruge varreza xarre	4,372,800	13	Shtrim trotuari Vrine	667,365
3	Rruge varreza mursi	7,275,480	14	Asfa q fshatit xarre shtepia e apostol stefanit	4,589,562
4	Ujësjiellësi Vrine shendelli	1,000,000	15	Tubi i leshimit ujesjellesi mursi	1,267,200
5	Kanalizimi i ujrave te zeza xarre	2,299,480	16	Asfaltim sheshi i fshatit mursi	3,472,788
6	Rikonstrukcion sheshi shkalle	1,684,000	17	Srrethim shk 9vjecare Vrine	497,076
7	Rikonstrukcion sheshi Vrine	1,490,860	18	Rehabilitim rruga qender shendelli	1,588,680
8	Ujësjiellësi xarre	6,958,108	19	Rruga Vrine butrint asfaltim	16,753,000
9	Rikonstrukcion rruga buf	990,871	20	Sistemin rruga vareza Vrine	2,007,636
10	Linja shperndarje uji	20,168,174	21	Kanali ushqyes rez.bezhanit	23,611,032
11	Asfaltim rruga hyrëse Vrine	1,150,000		Shuma	109,451,649

Konkluzion: Për AAGJM e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” të shprehura me(kosto historike)” në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,245,224,936 lekë nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” përfshihet edhe vlera prej 271,359,836 lekë që përfaqëson vlerën kontabël të trashëguar nga bilanci i ish Komunës Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në mungesë të inventarit fizik.

4. Titulli i Gjetjes: *KLSH konstatoi se, në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përfshihet edhe vlera prej 271,359,836 lekë që përfaqëson vlerën kontabël të trashëguar nga bilanci i ish Komunës Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në mungesë të inventarit fizik.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,207,212,103 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,192,489,363 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,245,224,936 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,271,872,569 lekë me një rritje prej 26,647,633 leke, e cila ka ardhur si rezultat e rikonstrukcioneve të kryera në 5 aktive gjatë vitit 2020 si: “Rikons. Rrugë Shkallë – Çiflik” në vlerën 4,688,640 lekë, “Rik. Ujësjiellës Konispol St.Pompa” në vlerën 963,000 lekë, Ndërtim Grop septike dhe KUZ shkolla Xarrë në vlerën 956,160 lekë, Rikonstrukcion i rrjetit te ndriçimit rrugor ne fshatrat e Bashkisë Konispol faza II në vlerën 8,057,313 lekë dhe Rikonstrukcion i Ujësjiellësit fshati Xarrë në vlerën 11,982,520 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 37 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 891,061,081 lekë sipas inventarit kontabël.

Për AAGJM e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” përfshihet edhe vlera prej 271,359,836 lekë që përfaqëson vlerën kontabël të trashëguar nga bilanci i ish Komunës Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në mungesë të inventarit fizik,

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe mungesa e analizës për vlerën 271,359,836 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën 28,408,149 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në shumën 29,076,157 lekë . Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38,756,715 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerë 37,970,915 lekë me rritje për vlerën 785,800 lekë e cila ka ardhur si rezultat e blerjeve të kryera gjatë vitit 2020. Kjo llogari është analizuar për 22 objekte pajisje dhe makineri në Bashkinë Konispol për vlerën 35,714,680 lekë, sipas inventarit kontabël paraqitet në tabelën e mëposhtme: në ish Komunën Xarrë për vlerën 3,042,035 lekë për 7 objekte, kurse në ish Komunën Markat nuk ka vlerë kontabël në këtë llogari. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogaritje si dhe ndryshimet nga viti 2019 në vitin 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”

Nr.	EMERTIMI	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor	Nr.	EMERTIMI	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor
1	Pompë uji 161 mm Bregu Koçit	398,450	14	Panel elektrik st.pomave Konispol	200,000
2	Trasformatore	399,000	15	Kuti me kablla	30,000
3	Pompë uji stacioni pompave	1,860,000	16	Kuti me pjese kembimi pomp	50,000
4	Pompë uji stacioni pompave	1,740,000	17	Pompa ujesjellesi	7,068,219
5	Pompë uji stacioni pompave	960,000	18	Kazan mbeturinash metalike	2,533,080
6	Elerktromotorrë të pompave	900,000	19	Pompë presioni zjarrfikse	120,000
7	Kuadër elektrik pompat Çiflik	288,000	20	Sharrë motorrike	60,000
8	Kuadër elektrik pompat Çiflik	900,000	21	Korrse bari motorike	60,000

Nr.	EMERTIMI	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor	Nr.	EMERTIMI	Gjendje ne fund te vitit ushtrimor
9	Konstruksion metalik i pompave	960,000	22	Uniforma zjarrfikse	545,800
10	Panel elektrik F V	240,000		Bashkia Konispol	35,714,680
11	Kundra valvol magazi	40,000		Xarrë	3,042,035
12	Pompë uji shkolla	15,000		Markat	0
13	Blerje skrep bujqesi	16,347,131	1	Totali	38,756,715

Konkluzion: Llogaria 214 ‘Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune’. Për vlerën kontabël të bilancit 38,756,715 lekë. Kjo llogari është analizuar për 22 objekte pajisje dhe makineri në Bashkinë Konispol për vlerën 35,714,680 lekë, në ish Komunën Xarrë për vlerën 3,042,035 lekë për 7 objekte, kurse në ish Komunën Markat nuk ka vlerë kontabël në këtë llogari.

- **Gjendja e llogarisë 215** “Mjete Transporti” në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 12,850,029 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,804,753 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 26,386,145 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 26,179,918 lekë, me rritje prej 206,227 lekë që përfaqëson automjetet zjarrfikës të dhuruar nga Bashkia Këlcyrë.

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2020

Nr.	EMERTIMI	Çelja 01.01.2020	Shtesa 2020	Mbyllja 2020
215	Mjete transporti	26,179,918	206,227	26,386,145
1	Autoveturë 7319	1,470,000		1,470,000
2	Autoveturë AA 195	3,328,800		3,328,800
3	Makina mbeturinave	380,000		380,000
4	Makine e madhe	1,380,000		1,380,000
5	Motorr	11,000		11,000
6	Motorr	10,000		10,000
7	Autoveturë ML	500,000		500,000
8	Autoveturë Benz Xarrë	895,000		895,000
9	Skrep punime bujqësore	2,818,800		2,818,800
10	Tojote "Mitsubish"	1,092,000		1,092,000
11	Makine transport mbeturina	9,281,310		9,281,310
12	Motorra për ujitjen	1,293,008		1,293,008
13	Makine zjarrfikse	3,720,000		3,720,000
14	Makine zjarrfikse		206,227	206,227

Për këto aktive është kryer inventari fizik,. Gjate 2020 është bere shtese mjete zjarrfikës me vlere 206,227 lek si transferuar pa pagese nga Bashkia Konispol flete dalje nga Bashkia nr.66 datë 19.08.2020 dhe janë bere hyrje nga Bashkia Konispol me nr. 11, datë19.08.2020.

Për këto automjete janë hapur kartelë inventariale me përgjegjësit materiale.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në datën 31.12.2020 është në vlerën 4,401,672lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 4,633,339 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet me të njëjtën vlerë kontabël 19,568,174 lekë si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020. Kjo gjendje përbëhet nga vlera e inventarit prej 8,970,862 lekë për Bashkinë Konispol, vlera prej 5,867,324 lekë e inventarit të Shkollës Konispol, vlera prej 4,161,416 lekë e NJA Xarrë dhe vlera prej 568,572 lekë e NJA Markat për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet, sipas pasqyrës **Aneks nr. 4, bashkëlidhur Raportit të Auditimit**.

Konkluzion: U konstatua se në Gjendjen e llogarisë **218 “Inventar Ekonomik”** me kosto historike në vlerën 19,568,174 lekë si në mbyllje të vitit 2020 dhe të vitit 2019. Ndërsa ish Komunës Markat

sot NjA i përket vlera prej 568,572 lekë, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të aktiveve dhe as kartela inventariale.

5. Titulli i Gjetjes: *KLSH konstatoi se, në gjendjen e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” me kosto historike në vlerën 19,568,174 lekë në mbyllje të vitit 2020 dhe të 2019. Ndërsa ish Komunës Markat sot NjA i përket vlera prej 568,572 lekë, është pa analizë, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të aktiveve dhe as kartela inventariale.*

Situata:

Gjendjen e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” në datën 31.12.2020 është në vlerën 4,401,672lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 4,633,339 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet me të njëjtën vlerë kontabël 19,568,174 lekë si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020. Kjo gjendje përbëhet nga vlera e inventarit prej 8,970,862 lekë për Bashkinë Konispol, vlera prej 5,867,324 lekë e inventarit të Shkollës Konispol, vlera prej 4,161,416 lekë e NJA Xarrë dhe vlera prej 568,572 lekë e NJA Markat për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike.

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe mungesa e analizës për vlerën 568,572 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: *I lartë*

Rekomandimi:

Sektori i Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Konispol, të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël prej 568,572 lekë të aktiveve të pasqyruara në llog. 218 “Inventar Ekonomik”, të bëhet inventarizimi nga komisioni i inventarizimit, të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, duke përcaktuar dhe personat përgjegjës material, si dhe të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2019 dhe 2020 Bashkia Konispol

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2019 dhe 2020 për Bashkinë Konispol dhe Njësia Administrative Xarrë dhe Markat.

Nga Titullari për vitin 2019 ka dalë urdhri me nr. 61 date 04.12.2019 “Për inventarizimin e aktiveve të Bashkisë Konispol për vitin 2019,” brenda të njëjtës urdhër janë dhe komisionet për vlerësimin e Aseteve dhe komisioni për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit.

Për vitin 2020 ka dalë urdhri me nr. 64/1 date 04.12.2020 “Për inventarizimin e aktiveve të Bashkisë Konispol për vitin 2020,” brenda të njëjtës urdhër janë dhe komisionet për vlerësimin e Aseteve dhe komisioni për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Konispol dhe për Njësia Administrative. Janë hartuar përmbledhëset sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2019 dhe 2020. Për të dy vitet mungojnë relacionet e për rezultatet e inventarëve nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike si dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve. Nga procesverbalet konstatohet se nuk ka patur materiale për nxjerrje jashtë përdorimit, e pasqyruar kjo dhe në shtesat/ pakësimet e llogarive në pasqyrat financiare.

Gjithashtu është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të mësipërm.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se janë kryer veprimet për inventarin fizik të të gjithë artikujve të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të llog.218 “inventar ekonomik”, llog. 31 “Materiale”, llog.32 “Inventar i imët”, llog. 215 “Mjete Transporti” janë krahasuar me gjendjen kontabël, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Fletët e inventarizimit janë firmosur nga komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësit material.

- Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Ripërdorimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërdorura sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2019 në vitin 2020 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refer Llog	E M E R T I M I	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakime gjatë vitit	Teprica në Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	6,108,601	5,619,601	489,000	0	489,000	0	6,108,601	6,108,601	
202	Studime dhe kërkime	6,108,601	5,619,601	489,000		489,000		6,108,601	6,108,601	
203	Konc, patenta,licenca e tjera	0	0	0				0	0	
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	1,841,954,597	155,701,335	1,686,253,262	29,639,660	37,783,229	0	1,871,594,257	193,484,564	1,678,109,693
210	Toka,troje,Terene	24,011,454	0	24,011,454				24,011,454	0	24,011,454
211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0				0	0	0
212	Ndertime e Konstruksione	488,999,200	68,761,004	420,238,196	2,000,000	21,011,910		490,999,200	89,772,914	401,226,286
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,245,224,936	52,735,573	1,192,489,363	26,647,633	11,924,894		1,271,872,569	64,660,466	1,207,212,103
214	Instal tekn,mak,paisj vegla p	37,970,915	8,894,758	29,076,157	785,800	1,453,808		38,756,715	10,348,566	28,408,149
215	Mjete transporti	26,179,918	10,375,165	15,804,753	206,227	3,160,951		26,386,145	13,536,116	12,850,029
216	Rezerva shtetore	0	0	0				0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0				0	0	0
218	Inventar ekonomik	19,568,174	14,934,835	4,633,339		231,667		19,568,174	15,166,502	4,401,672

Nr. Refer Llog	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksime gjate vitit	Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
24	AQT te demtuara	0	0	0				0	0	0
28	Caktime	0	0	0				0	0	0
	T O T A L I (I + II)	1,848,063,198	161,320,936	1,686,742,262	29,639,660	38,272,229	0	1,877,702,858	199,593,165	1,678,109,693

Nga verifikimi i përllogaritjeve të amortizimit të AAGJ rezultojnë se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrimit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimit e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën..

Referuar Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuar të normës së amortizimit mbi totalin e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 20 dhe 21, rezultojnë se ka pasaktësi në përllogaritjet e amortizimit vjetor të AAGJ. Kështu:

Në vitin ushtrimor 2020 janë kontabilizuar përllogaritjet e amortizimit të aktiveve materiale për vlerën 199,593,165 lekë është debituar llog. 1013 “Konsumi i aktiveve materiale” në kredi të llogarive: llog.2192 “Amortizim Ndërtesa” për vlerën 89,772,914 lekë, llog. 2193 “Amortizim Rruge, kanalizime” për vlerën 64,660,466 lekë, llog. 2194 “Amortizim Makineri e pajisje, instrumente e vegla” në vlerë 10,348,566 lekë, llog. 2195 “Amortizim Mjete transporti” në vlerën 13,536,116 lekë dhe llog. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” në vlerën 15,166,502 lekë. Në fund të vitit ushtrimor për vlerën -38,272,229 lekë është kryer veprimi kontabël mbyllës: në debi të llog. 1012 “Paksime të fondeve baze” dhe në kredi 1013 “Konsumi i aktiveve të qëndrueshme”.

Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultojnë se, ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likuidimet për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti	Operatori ekonomik	Date	Gjithsejtë Vlera e plotë e kontratës (me TVSH)	Likuidimi sipas viteve			Likuiduar gjithsejtë për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020	Pa u likuiduar deri me 31.12.2020
					2018	2019	2020		
	b	1	6	10 (7+9)	11	12	13	14(11+12+13)	15 (10-14)
1	Rik. Shk. "Rait Bajo" Shales e ndert kopsht B.Komis	E...	24.09.2018	61,382,057	32,141,620	23,089,856	2,000,000	57,231,476	4,150,581
2	Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Xarrë	E...	09.06.2020	58,348,704			11,712,520	11,712,520	46,636,184
	Investime Shuma							68,943,996	

Konkluzion: Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për blerje të aktiveve afatgjata dhe për rastet e investimeve të kryera nga firma sipërmarrëse punimesh, pas kryerjes së testeve në ditarët e bankës, magazinës dhe partitarin e investimeve, kontabilizimet kanë filluar në momentin e pagesave të faturave dhe situacioneve pjesore dhe jo në momentin e mbërritjes së tyre në institucion. Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore më të gjatë rezultojnë se llog. 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara,

duke u mbyllur kjo llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivet deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu për 2 kontrata të lidhura në vitet 2018-2020 janë paguar pjesërisht deri me datë 31.12.2020 në vlerën 68,943,996 lekë, vlerë e cila në fakt i përket gjendjes debitorë të llog. 231 "Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale (investime në proces)" Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23 në të cilën përcaktohet: *"Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:*

- Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve. - Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, "Investime". - Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, "Investime" ndahet në dy llogari treshifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatëshifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve. - Llog.230, "Investime për aktive afatgjata jomateriale", të analizuara në llogari shtatëshifrore; dhe - Llog. 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", të analizuara në llogari shtatëshifrore." Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohet në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara."

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore është në total 58,758,548 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 0 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"** paraqitet në vlerën 4,596,397 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguheshin në Janar të vitit pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat" paraqitet** në vlerën kontabël 239,776lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguheshin në janar të vitit pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore" paraqitet në** vlerën 1,302,930 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 436 "Sigurime shëndetësore".** Për vlerën kontabël 180,453 lekë.

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi vlera 90,226 lekë.

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 90,226 lekë.

Gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogaritje në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 11,524,209 lekë dhe në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 13,632,779 lekë. Në aktin e rakordimit me degën e Thesarit Sarande rezultoi se:

Në fund të vitit 2019 janë trashëguar 13,572,779 lekë detyrime të pakthyera ndërkohë që në bilanc gjendja e kësaj llogaritje në mbyllje të vitit 2020, duhet të pasqyrohej më pak për vlerën 60,000 lekë që i përket pullave të dhëna në përdorim Zyrtarë të Gjendjes Civile, të arkëtuar vitin pasardhës.

Në fund të vitit 2020 janë trashëguar 11,524,209 lekë detyrime te pakthyer ndërkohë që në bilanc gjendja e kësaj llogaritje në mbyllje të vitit 2020, duhet të pasqyrohet më pak për vlerën 176,000 lekë që i përket pullave të dhëna në përdorim Zyrtar të Gjendjes Civile, të arkëtuar vitin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin(detyrime)”** përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 19,076,093 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 27,335,804 lekë dhe rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 468 në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 8,004,841 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13,578,979 lekë, vlera që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinacuar, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e kësaj llogaritje paraqitet në tabelën aneks nr bashkëlidhur aktkonstatim.

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2020

N/R	EMRI I FURNITORIT	Nr/ datë	Detyrime Me 31.12.2020
14	Z...	26.11.2020	13,279
16	Q. M.	42 24.11.2020	171,660
17	L...	28.12.2020	2,352,798
18	U...	30.11.2020	10,500
19	Z...	247 30.11.2020	30,227
20	L...	357 31.10.2020	4,081,640
22	M...	587/31.12.2020	119,600
23	L...	392/30.11.2020	3,380,552
24	V. P.	117/13.12.2020	297,998
26	V. GJ.	22/23.12.2020	258,100
27	F. T.	70/30.12.2020	940,000
28	F. T.	69/28.12.2020	954,300
29	F. T.	66/28.12.2020	950,350
	A...		17,975
	TOTALI		13,578,979

Fondi i Konsoliduar në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 1,686,193,553 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 1,697,196,106 lekë.

96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,686,193,553	1,697,196,106
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,686,193,553	1,697,196,106
98	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,683,219,735	1,691,852,304
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	2,973,818	5,343,802
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmen		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		0
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,744,952,101	1,743,786,873

Fondi i konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e Fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 1,744,952,101 lekë me pasivet (detyrimet) në vlerën 58,758,548 lekë.

Në analizë: Formati nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2020 sipas pasqyrës aneks nr. 5, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Sipas këtij aneksi paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (grant) në shumën 153,409,634 lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo Njësi vendore në vlerën 38,480,121 lekë nga të cilat: të ardhura tatimore në vlerën 17,659,203 lekë dhe të ardhura jo tatimore në vlerën 20,820,918 lekë, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Sarandë. Përfshirja në këtë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhurnuar nga Drejtoria e taksave e tarifave vendore. Gjendja e secilës llogari të të ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura në llogarite analitike të aktit të rakordimit me degën e thesarit Sarandë. Në mënyrë analitike të llogaritë e të ardhurave paraqiten:

- Gjendja e llogarisë **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2020 në vlerën 130,864 lekë e cila referuar dhe Aktrakordimin me thesarin përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*. Nga viti 2018 ky zë vjen me ulje në vlerën 152,084 lekë, si rezultat i përjashtimeve nga kjo taksë e disa bizneseve.

- Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2020 në vlerën 15,211,021 lekë me një rritje prej 3,166,946 lekë nga viti 2019, sipas Aktrakordimin me Degën e Thesarit Sarandë në të përfshihen Taksa mbi token bujqësore në vlerën 12,270,948 lekë, Taksa mbi ndërtesën në vlerën 2,708,553 lekë dhe Taksë mbi truallin në vlerën 231,520 lekë.

- Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** paraqitet në bilanc për vitin 2020 në vlerën 2,317,318 lekë, me një zbritje prej 485,483 lekë nga viti 2019, ku sipas Aktrakordimin me thesarin në të përfshihen.

Emërtimi i llogarive	Vlera viti 2020
Taksë vendore për zënien e hapësirës publike	35,000
Taksë vendore e ndikimit të infrastrukturës në ndërtimet e reja	1,436,741
Taksë vendore për fjetjen në hotel	13,297
Takse për thjerrjen e bagëtive	0
Takse vendore e tabelës	11,280
Takse mirembajtje rurale	821,000
Taksë vendore për regjistrim biznesi	0
Llog.7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtari”	2,317,318

- Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e vitit 2020 në vlerën 6,139,909 lekë, me një rritje prej 400,933 lekë, ku sipas Aktrakordimin me thesarin janë përfshirë: “Të ardhura nga qira për troje” në vlerën 899,388 lekë, “Të ardhura nga qira për tokë bujqësore” në vlerën 681,651 lekë dhe “Tarife qira kullote” në vlerën 4,558,870 lekë.

- Gjendja e llogarisë **7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore”** paraqitet në bilancin e vitit 2020 në vlerën 8,529,533 lekë, me një rritje prej 2,797,317 lekë nga viti 2019, në të cilën përfshihen “Tarifë për leje transporti” në vlerën 1,203,650 lekë, “Tarife Pastrimi dhe higjienë” në vlerën 2,006,700 lekë dhe “Të tjera Tarifa administrative dhe rregullatore” në vlerën 5,319,183 lekë.

- Gjendja e llogarisë **7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”** pasqyrohet në bilancin e vitit 2020 për vlerën kontabël 6,151,476 lekë me një rritje prej 3,620,482 lekë nga viti 2019, ku përfshihet “E ardhura nga parkingu i automjeteve” në vlerën 48,000 lekë dhe “Të tjera të ardhura sekondare, Bashkia, vaditje fusha” në vlerën 6,103,476 lekë.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në vlerën prej 6,319,556 lekë përbëhet nga vlera e detyrimeve të dhjetorit të palikujduara për shpenzime personeli për paga (600) prej 4,596,397 lekë, për kontribute sig.shoqërore e shëndetësore prej 1,483,383 lekë, për tatimin ndaj te ardhurave në vlerën 239,776 lekë

Po kështu shumat e paraqitura në gjendjet e llogarive të shpenzimeve të konstatuara sipas natyrës të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuara në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor në Aktrakordin e me degën e thesarit plus detyrimet e mbetura të palikujduara në fund të vitit ushtrimor.-detyrimet likuiduara për vitin paraardhës.

Pesha specifike e këtyre shpenzimeve të pasqyruara në këtë format si: Shpenzimet në llog. (600) “Paga, shpërblime e të tjera personeli” në vlerën 64,230,582 lekë zënë 34 % të totalit të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (601) “Kontribute të sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 10,462,359 lekë zënë 6% të totalit të shpenzimeve; shpenzimet në llog. (602) “Mallra shërbime të tjera” në vlerën 55,147,483 lekë zënë 29% të totalit të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 55,928,549 lekë zënë 29 % të totalit të shpenzimeve, në të cilën përfshihen transferta për ndihmën ekonomike dhe për invaliditetin.

Për vitin 2019 totali i te ardhurave është 173,855,341 lekë dhe totali i shpenzimeve është 168,511,539lekë. Diferenca e tyre në vlerën 5,343,802 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Për vitin 2020 totali i të ardhurave është 191,889,755 lekë dhe totali i shpenzimeve është 188,915,937 lekë. Diferenca e tyre **në vlerën 2,973,818** lekë rakordon me gjendjen e **llog.85** “Rezultatit e ushtrimit” .

- Nga testi kontrollit për vitet 2019 dhe 2020 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë: Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konformë nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 gjerat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

- Liqishmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, Listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali

është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Auditim mbi zbatimin e strukturës dhe organikës së miratuar

Për vitin 2019, me Vendim të KB nr. 52, datë 20.12.2018 “Për miratimin e numrit dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Konispol”, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 6/1, datë 8.01.2019, gjithsej **136 punonjës**.

Për vitin 2020, me Vendim të KB nr. 26, datë 11.12.2019 “Për miratimin e numrit dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Konispol”, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 2000/1, datë 27.12.2019, gjithsej **139 punonjës**, pasqyra:

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr i departamenteve (sektorëve)	Nr i drejtorive	Nr i stafit	Mbulimi nga të ardhurat e veta
2019	62,292	9	6	136	19%
2020	24,916	16	5	139	19%

- Auditim mbi dokumentimin e të dhënave për personelin

Janë zbatuar drejt kërkesat e UMF nr. 30, date 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, kreu III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre” pika 69, pasi listëpagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur ne te dhënat e dokumentacionit baze (listëprezencat te cilat janë te firmosura nga përgjegjësit e zyrave), specialisti i pagave, përgjegjësi i financës, nga punonjësi i burimeve njerëzore dhe nga Kryetari i Bashkisë. Sipas strukturës së miratuar me VKB, kjo njësi administrative ka gjithsej **45** pozicione pune të vlerësuara me status të Nënpunësit civil, si **1** (një) pozicion i kategorisë së lartë, **4** (katër) pozicione të kategorisë së mesme drejtues, **3** (tre) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **37** (tridhjetë) pozicione të kategorive ekzistuese. Konstatohet se **24** pozicione janë të plotësuara me punonjës me status (me konkurrim), sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 “Për Nënpunësit civil” i ndryshuar dhe **21** pozicione janë vakant. Për periudhën viti 2019 dhe 2020 janë emëruar gjithsej **62** punonjës në pozicione të ndryshme, emërimet të cilat janë bërë në zbatim të akteve ligjore. Për këtë periudhë janë larguar gjithsej 9 punonjës sipas arsyeve (kërkesë, dëshirë dhe dalje në pension) dhe asnjëri nga punonjësit nuk ka bërë ankimi në gjykatë.

-Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve , shtesat mbi to , shpërblimeve.

Me Vendim të KB është miratuar niveli i pagave për punonjësit e Bashkisë, shpërblimi për Këshilltarët dhe Kryetarët e fshatrave në mbështetje të VKM nr. 177, datë 8.3.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165,datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" .

Referuar analizës së riskut për testet e kryera mbi pagesën e punonjësve (klasifikimin dhe nivelin arsimorë), për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2019 dhe Janar, Mars, Maj, Nëntor dhe Dhjetor 2020,

konstatohet se pagesat janë në përputhje me VKM nr. 177, datë 8.3.2017 “ Për disa ndryshime dhe shitesa në Vendimin nr.165 datë 2/3/2016”, nuk u konstatuan probleme.

- Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e ndalesave për tatimin mbi të ardhurat personale, për detyrimin ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore, xhirimi ne favor të buxhetit të shtetit.

Nga auditimi në tërësi i listepagesave për periudhën e audituar, u konstatua se llogaritja dhe ndalesat për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale janë bërë në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.7870, datë 13/10/1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

- Mbi administrimin e ndihmave ushqimore në Bashkinë Konispol, të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH).

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Konispol ka përfituar ndihma ushqimore, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Konispol, rezulton se Fletëdalja nr. 238, datë 03.06.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.9, datë 05.06.2020 për ushqimet në vlerën 64,922 lekë.

Sipas listës së Zyrës së Ndihmës Ekonomike për 17 familje ushqimet janë bërë dalje nga magazina me Fletëdalje nr. 07, datë 06.06.2020.

Drejtoria Ekonomike në bashki ka kontabilizuar të gjitha veprimet në ditarin e magazinës, duke e debituar llogarinë përkatëse materiale.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIM

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i llogarisë 32 “*Inventari i imët* ” e cila paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020, aktive për të cilat është kryer inventar fizik dhe është krahasuar me Inventarin kontabël vetëm për vlerën 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogaritje në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Ndërsa për vlerën 2,822,680 lekë që i përket NJA Markat, e cila është e pa analizuar në kontabilitet nuk është kryer inventar fizik. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Markat i paraqitur pa analizuar këtë llogari, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. pika 30 (Trajtuar hollësisht në faqe 14-32, të Raport Auditimit).

1. Rekomandimi: Bashkia Konispol nëpërmjet një komisioni të ngritur me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin llog 32 “*Inventari i imët*”, për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik. Të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” IV. “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në bilanc paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 24,011,454 lekë. Edhe sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” si mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2019 paraqitet në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, kjo është e pa analizuar, nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 (Trajtuar hollësisht në faqe 14-32, të Raport Auditimit).

2. Rekomandimi: Kryetari I Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, llogaria 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 401,226,286 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 420,238,196 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata kosto historike*”) në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 488,999,200 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 490,999,200 lekë me rritje prej 2,000,000 lekë si rezultat i investimit të kryer për rritjen e AQT “Rikonstruksion i Shkollës së Shalës” në vlerën 2,000,000 lekë. Referuar inventarit kontabël të gjendjes së kësaj llogaritje rezulton se: Bashkia Konispol ka 13 objekte në vlerën 300,235,141 lekë, analiza e së cilës sipas inventarit kontabël, Njësisë Administrative Xarrë ka 18 objekte me vlerë prej 31,586,314 lekë dhe vlera prej 159,177,745 lekë e Njësisë Administrative Markat. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është përfshirë vlera prej 159,177,745 lekë që i përket NJA Markat është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë

Konispol, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 (Trajtuar hollësisht në faqe 14-32, të Raport Auditimit).

3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,207,212,103 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 1,192,489,363 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,245,224,936 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,271,872,569 lekë me një rritje prej 26,647,633 leke, e cila ka ardhur si rezultat e rikonstruksioneve të kryera në 5 aktive gjatë vitit 2020 si: “Rikons. Rrugë Shkallë – Çiflik” në vlerën 4,688,640 lekë, “Rik. Ujësjiellës Konispol St.Pompa” në vlerën 963,000 lekë, Ndërtim Gropë septike dhe KUZ shkolla “Xarrë” në vlerën 956,160 lekë, Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor në fshatrat e Bashkisë Konispol faza II në vlerën 8,057,313 lekë dhe Rikonstruksion i Ujësjiellës fshati Xarrë në vlerën 11,982,520 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 37 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 891,061,081 lekë sipas inventarit kontabël. Për AAGJM e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përfshihet edhe vlera prej 271,359,836 lekë që përfaqëson vlerën kontabël të trashëguar nga bilanci i ish Komunës Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në mungesë të inventarit fizik, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 (Trajtuar hollësisht në faqe 14-32, të Raport Auditimit).

4. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se, gjendja e llog.218 “Inventar Ekonomik”, në mbyllje të pasqyrave financiare të viteve 2019 dhe 2020, paraqitet me kosto historike në të njëjtën vlerën prej 19,568,174 lekë. Nga testimi i inventarit kontabël të aktiveve të kësaj llogarie, rezultoi se vlera prej 568,572 lekë i përket NJA Markat, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të aktiveve dhe as kartela inventariale. Në vitin 2016 është bërë

inventari fizik vetëm për gjendjen fizike në sasi, por pa çmim, pra mungon inventarizimi kontabël, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, Kreu III. Pika 30 *(Trajtuar hollësisht në faqe 14-32, të Raport Auditimit)*.

5.1Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Konispol, të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël prej 568,572 lekë të aktiveve të pasqyruara në llog. 218 “*Inventar Ekonomik*”, të bëhet inventarizimi nga komisioni i inventarizimit, të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, duke përcaktuar dhe personat përgjegjës material, si dhe të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Tematik.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT